



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 663/1 Prot.

Tiranë, më 02 /05/ 2019

**V E N D I M**

**Nr. 57, Datë 02 / 05 / 2019**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.174 Regj., datë 12.11.2018, të Ç. P, kundër Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Kuçovë, me pretendim diskriminimin për shkak “*të bindjeve politike*<sup>1</sup>”. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**KONSTATOI:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, Ç. P, nëpërmjet Urdhërit nr.19, datë 18.01.2016 të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor (DSHS) Kuçovë, ka filluar marrëdhëniet e punës në detyrën “shofer ambulance”. Këto marrëdhënie kanë vazhduar deri në datën 18.01.2018, pasi me anë të “Njoftimit nr.57, datë 17.01.2018 të DSHS Kuçovë” i është komunikuar përfundimi i kontratës së punës. Mes subjektit ankues dhe punëdhënësit, DSHS Kuçovë janë lidhur disa kontrata të njëpasnjëshme pune, dhe konkretisht citohen:

- Kontratë individuale me kohëzgjatje 3 muaj, për periudhën 18.01.2016-18.04.2016.
- Kontratë individuale me kohëzgjatje 1(një) vit, për periudhën 18.04.2016-18.04.2017.
- Kontratë individuale me kohëzgjatje 1(një) vit, për periudhën 18.01.2017-18.01.2018.

Ç. P shprehet se është emëruar në detyrën e shoferit të ambulancës, bazuar në organikën e DSHS Kuçovë, në një vend pune i cili ka qenë i lirë në atë kohë dhe se aktualisht atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës me qëllim favorizimin e një personi tjetër, i cili është emëruar në vend të tij.

Ankuesi shprehet se, arsyetimi i përdorur nga ana e DSHS Kuçovë se atij i ka përfunduar afati i kontratës dhe për këtë shkak i ndërpritën dhe marrëdhëniet e punës me institucionin, nuk qëndron dhe bëhet me qëllim për të fshehur shkakun e vërtetë, i cili lidhet realisht me bindjet e tij politike.

<sup>1</sup> Subjekti ankues ka kartë anëtarësimi në forcën politike LSI, me nr.28468/ 06-09-04.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Ankuesi provon me dokumentin e kartës së anëtarësisë të subjektit politik LSI, se është aktivist i kësaj force politike dhe deklaroi se punëdhënësi i tij është përfaqësues i partisë në qeverisje, Partisë Socialiste. Ai citon se me ardhjen në detyrë të drejtuesit të ri të institucionit, është ndier nën presion prej tij, pasi i është deklaruar në mënyrë jo zyrtare se të gjithë anëtarët e LSI do të largohen nga puna.

Ç. P shprehet se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë me punojësit e tjerë në kushte të njëjta me të, pasi në ndryshim nga shoferët e tjerë të ambulancës, vetëm atij i është zgjidhur marrëdhënia e punës pas përfundimit të afatit të kontratës. Ai shprehet se ky qëndrim i punëdhënësit është tendencioz dhe diskriminues.

Në përfundim të ankesës, ankuesi kërkon nga Komisioneri të konstatojë diskriminimin e tij për shkak të bindjeve politike, nga ana e DSHS Kuçovë.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>3</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1584/2 prot., datë 15.11.2018 i është kërkuar informacion Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Kuçovë, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

<sup>3</sup>Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Me shkresën me nr.977/1 prot., datë 26.11.2018<sup>4</sup> DSHS Kuçovë, ka informuar Komisionerin se:

- *“Punonjësi Ç. P ka qenë i punësuar pranë DSSH Kuçovë prej datës 18.01.2016 në pozicionin “Shofer ambulance”. Pas periudhës së provës dhe rinovimit të njëpasnjëshëm të dy kontratave një vjeçare këtij punonjësi i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 18.01.2018, duke u bazuar në argumentin se kontrata e tij e punës është me afat të caktuar. Duke marrë në konsideratë se çdo fillim viti Struktura Organike ndryshon sipas pretendimeve që institucioni ynë kishte për shkurtimin e këtij pozicioni është marrë masa për largimin e një prej shoferave të ambulancës, konkretisht, Ç. P.*
- *Pretendimet se është diskriminuar për shkak të bindjeve të tij politike nuk qëndrojnë. Ai ka pretenduar se drejtuesja e institucionit i përket partisë në qeverisje, Partisë Socialiste, pretendim i pabazuar ky, pasi M. P është emëruar në bazë të një konkurimi transparent dhe ka kaluar të gjitha testet e nevojshme praktike dhe teorike të organizuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS). Ky emërim nuk ka asnjë ngjyrë politike por bazohet në aftësitë profesionale dhe drejtuese të individit.*
- *Pretendimi i Ç. P se i është komunikuar nga persona jo zyrtarë se të gjithë anëtarët e LSI-së do të largohen nga puna, nuk qëndron pasi një gjë e tillë nuk ka ndodhur për asnjë nga punonjësit që mund të jenë anëtarë të LSI-së dhe kjo është lehtësisht e vërtetueshme”.*

DSSH Kuçovë, lidhur me punësimin e ri të kryer në pozicionin “Shofer ambulance”, ka sqaruar se, ky punësim është kryer disa muaj më vonë, kur nga MSHMS u është konfirmuar se Struktura Organike nuk do të ndryshohej për vitin 2018. Prandaj ata arsyetojnë se ky fakt vërteton se ndërprerja e marrëdhënies së punës me Ç. P nuk ka lidhje me bindjet e tij politike apo favorizimin e dikujt tjetër, pasi nëse do të ishte kështu do të ishte kryer menjëherë pas shkëputjes së tij nga puna. Ata arsyetojnë se për rekrutimin e punonjësit të ri janë ndjekur dhe zbatuar të gjitha afatet dhe procedurat, bazuar në Urdhërin nr.506, datë 18.09.2013<sup>5</sup> dhe në Urdhërin nr.511, datë 13.12.2011, të Ministrit të Shëndetësisë<sup>6</sup>. DSSH Kuçovë ka theksuar faktin se nga dosja e Ç. P rezulton se ai është rekrutuar pa asnjë konkurim dhe pa respektuar procedurat sipas akteve ligjore në fuqi.

DSSH Kuçovë ka cituar se: *“Ai nuk ka paraqitur asnjë ankesë për diskriminim pranë institucionit tonë. Aktualisht pranë institucionit janë të punësuar 7 (shtatë) shoferë ambulance<sup>7</sup>. Të gjithë këta punonjës, si dhe punonjësit e tjerë të institucionit, pavarësisht kohëzgjatjes së punës janë me kontratë pune me afat të caktuar, procedurë e cila ka funksionuar ndër vite në institucionet e Spitaleve dhe Shërbimeve Parësore Shëndetësore. Pra, nuk jemi para një trajtimi të pabarabartë pasi të gjithë punonjësit janë të punësuar me kontratë me afat të caktuar”.*

<sup>4</sup> Protokolluar me Tonën, me nr.1584/3 prot., datë 03.12.2018.

<sup>5</sup> “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambjentëve dhe hapësirave në institucionet shëndetësore”.

<sup>6</sup> “Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor”.

<sup>7</sup> Në cilësi prove janë dërguar kopje të dosjeve personale të 7 shoferëve të punësuar, aktualisht.

DSSH Kuçovë ka sjellë në cilësi prove kopje të dokumentacionit poshtëshënuar:

- Aktit të emërimit të M. P, titullare e institucionit.
- Urdhërit nr.506, datë 18.09.2013 të Ministrit të Shëndetësisë “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambjenteve dhe hapësirave në institucionet shëndetësore”.
- Urdhërit nr.511, datë 13.12.2011 të Ministrit të Shëndetësisë “Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor”.
- Shkresës me kriteret e punësimit për punonjësit “Shofer ambulance”.
- Kopje të dosjes personale të Ç. P.
- Kopje të dosjes personale të punonjësit që e ka zëvendësuar, A. D.
- Kopje të dosjes personale të 6 punonjësve “Shoferë ambulance”: A. T, S. T, A. L, E. G, S. S, M. P.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së Ç. P, Komisioneri nëpërmjet shkresës me nr.183 prot., datë 06.02.2019 ka ftuar palët në proces, të marrin pjesë në seancën dëgjimore të datës 12.02.2019.

Seanca u zhvillua në mungesë të subjektit ankues dhe me praninë e përfaqësuesit me autorizim<sup>8</sup> të DSHS Kuçovë, znj.M. Xh.

Përfaqësuesja e DSHS Kuçovë, u qëndroi të njëjtave parashtrime të sjella shkresërisht pranë KMD-së. Ajo u shpreh se, në ditët në vijim, DSHS Kuçovë do të dërgonte prova të tjera që do të provojnë se ka patur dhe persona të tjerë me bindje politike të njëjta me ato të ankuesit (LSI) dhe që vijojnë të jenë në marrëdhënie pune; gjë që provon se bindjet e tij politike nuk kanë shërbyer si shkak për largimin nga puna.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me pretendimin e ankuesit për trajtim të padrejtë dhe të pa barabartë nga ana e DSHS Kuçovë.**

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

<sup>8</sup> Referuar Autorizimit nr.287 prot., datë 11.02.2019, të DSHS Kuçovë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësohte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“ Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Mbështetur në dokumentacionin dhe provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezulton se:

Subjekti ankues nëpërmjet Urdhërit nr.19, datë 18.01.2016 të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor (DSHS) Kuçovë, ka filluar marrëdhëniet e punës në detyrën “shofer ambulance”. Mes tij dhe punëdhënësit, DSHS Kuçovë janë lidhur disa kontrata të njëpasnjëshme pune, dhe konkretisht citohen:

- Kontratë individuale me kohëzgjatje 3 muaj, për periudhën 18.01.2016-18.04.2016.
- Kontratë individuale me kohëzgjatje 1(një) vit, për periudhën 18.04.2016-18.04.2017.
- Kontratë individuale me kohëzgjatje 1(një) vit, për periudhën 18.01.2017-18.01.2018.

Ndërkaq, me anë të “Njoftimit nr.57, datë 17.01.2018 të DSHS Kuçovë” ankuesit i është njoftuar përfundimi i kontratës së punës.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se është trajtuar në mënyrë diskriminuese nga punëdhënësi, lidhur me largimin e tij nga puna, Komisioneri gjykon se DSHS Kuçovë ka barrën e provës<sup>9</sup> të provojë që largimi i ankuesit nga puna është kryer për arsye të ligjshme dhe të justifikuar.

---

<sup>9</sup>Kodi i Punës në neni 9 “Ndalimi i diskriminimit, pikat 9 dhe 10 e tij parashikojnë se: *“9. Në rastin kur një person pretendon se është cënuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.*

*10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”*.

Bazuar në Urdhërin nr.511, datë 13.12.2011 të Ministrit të Shëndetësisë “Për kriteret e punësimit në Shërbimin Shëndetësor Publik”, DSHS Kuçovë, lidhur me punësimin e shoferëve në këtë Institucion ka ndjekur përmbushjen e kriterëve të mëposhtëm:

- Patentë C.
- Eksperiencë pune 5 vite.
- KLM një herë në vit.
- Alkoolemia 0%.
- Preferohet arsimi i mesëm.
- Preferohen kurse trajnimi për dhënien e ndihmës së shpejtë, të çertifikuara.

Në referim të përmbushjes së kriterëve sipërcituar, nga këqyrja dhe verifikimi i dosjeve personale të shoferëve të emëruar pranë DSHS Kuçovë, rezultoi se:

- Subjekti ankues dhe shtatë shoferët<sup>10</sup> që aktualisht janë të emëruar si punonjës të DSHS Kuçovë: A. T, S. T, A. L, E. G, S. S, A.D, M. P, përmbushin të gjitha kriteret e shprehura në urdhërin e cituar më lart në vendim.
- Përsa i takon procedurës së emërimit të tyre në detyrën e shoferit të ambulancës, për të gjithë është ndjekur e njëjta procedurë emërimi. Verifikohet se të gjithë punonjësit shoferë ambulance, fillimisht janë emëruar me kontrata individuale 3 mujore (periudhë prove) dhe më pas me ta janë nënshkruar kontrata me afat të caktuar, një vjeçare. Pra, lidhur me emërimin e tyre në punë, DSHS Kuçovë ka ndjekur të njëjtën procedurë si për subjektin ankues, ashtu dhe për shtatë shoferët e tjerë.
- Lidhur me performancën në punë, Komisioneri ka verifikuar dokumentacionin e depozituar pranë KMD, për secilin shofer (përfshi dhe ankuesin) nga ku ka rezultuar se, për të gjithë shoferët vlerësimi ka qenë pozitiv dhe nuk ka patur asnjë vërejtje apo masë disiplinore ndaj tyre.

Në këto kushte, në analizë të situatës së ankuesit lidhur me largimin e tij nga puna, Komisioneri vlerëson se, justifikimi i DSHS Kuçovë bazuar në argumentin se marrëdhëniet e punës me të u ndërprejnë për shkak se kontrata e tij ishte me afat të caktuar dhe Institucioni po merrte në konsideratë shkurtrimin e një vendi pune (shofer ambulance) nuk është objektivisht i justifikuar për këto arsye:

*Së pari*, peretendimi i DSHS Kuçovë se fakti i mos ndryshimit të Strukturës Organike të Institucionit për vitin 2018 iu është komunikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) pas momentit të largimit të ankuesit nga puna, nuk qëndron dhe është i pa argumentuar, pasi ky largim është bërë mbi bazën e hamendësimit të një fakti që ende nuk kishte ndodhur. Pra, ankuesi nuk mund të largohet nga puna me idenë se “*mund të shkurtohej vendi i tij i punës*”, pa u komunikuar më parë një fakt i tillë, siç ishte ndryshimi i strukturës dhe për më tepër pa u iniciuar asnjë procedurë e tillë nga ana e MSHMS.

---

<sup>10</sup> Kopje të akteve të dosjeve personale të secilit prej tyre janë të depozituara në dosjen e subjektit ankues, pranë KMD.

Së dyti, lidhur me faktin e pretenduar nga ankuesi se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë me shoferët e tjerë, në kushte të njëjta, Komisioneri vlerëson se, nga ana e DSHS Kuçovë nuk u sollën prova dhe argumenta bindëse që të mund të provonin apo përligjinin faktin se, largimi i ankuesit nga puna, ka ardhur për arsye të ligjshme dhe objektive.

Kjo për shkak se, të gjithë shoferët e ambulancave ishin (dhe janë) me kontrata me afat të caktuar një vjeçare, dhe asnjërit prej tyre nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës me përfundimin e këtij afati, me argumentimin se janë me afat të caktuar. Po ashtu, vlerësimi i performancës së ankuesit në punë nga ana e DSHS Kuçovë ka qenë “shumë mirë”, gjë që nuk lë shteg për justifikimin e mos rinovimit të kontratës së punës me të dhe rëndon më tepër pozitën e punëdhënsit në këtë rast.

Nga analiza e sipërpërmendur dhe në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se ankuesi është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e DSHS Kuçovë, në krahasim me shoferët e tjerë që ndodheshin në kushte të njëjta apo të ngjashme me të.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e subjektit ankues se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe disfavorizuese, krahasuar me shoferin e emëruar pas largimit të tij nga puna, A.D, Komisioneri vlerëson se, ankuesi nuk është në kushte të njëjta apo të ngjashme me punonjësin sipërcituar, për rrjedhojë nuk mund të krahasohet me të.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Mbështetur në nenin 2<sup>11</sup>, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se “*bindjet politike*” janë shkak për të cilin ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje.

---

<sup>11</sup>“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje që nxit diskriminim.”

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Po ashtu, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në nenin 9<sup>12</sup> të tij “Ndalimi i diskriminimit”, parashikon “bindjet politike” si shkak për të cilin ky ligj ofron mbrojtje nga diskriminimi.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”, Komisioneri gjykon se “bindjet politike” konsiderohen si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se e mbart atë. Subjekti ankues ka kartë anëtarësimi në forcën politike LSI, me nr.28468/ 06-09-04.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.**

Për të vërtetuar faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e DSHS Kuçovë duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>13</sup> dhe trajtimit të padrejtë apo të pafavorshëm të ankuesit.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës<sup>14</sup>, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues i është nënshtruar një qendrimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e DSHS Kuçovë, krahasuar me shoferët e tjerë të ndodhur në kushte të njëta apo të ngjashme me të.

Në kontekst të provimit të faktit që ankuesi nuk është diskriminuar për shkak të bindjeve të tij politike, DSHS Kuçovë ka depozituar pranë KMD, në cilësi prove dokumentacion përkatës, me anë të të cilit provon faktin se ka dhe punonjës të tjerë të këtij Institucioni, përfshirë dhe shoferë

---

<sup>12</sup> “Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët”.

<sup>13</sup> Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

<sup>14</sup> Shih Ndarjen III, nëndarja A, të vendimit të KMD.



ambulance, që deklarojnë bindjet e tyre politike, si dhe anëtarësinë në subjektin politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”, dhe që nuk janë penalizuar për këtë shkak, por vijojnë të jenë në punë dhe aktualisht.

Referuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht konstatimit të faktit se Ç. P i është nënshtruar trajtimit të padrejtë e disfavorizues nga ana e DSHS Kuçovë, krahasuar me shoferët e tjerë të ndodhur në kushte të njëta apo të ngjashme me të, nuk provohet se largimi nga puna i ankuesit ka ardhur për shkak të bindjeve të tij politike.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të Ç. P, nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Kuçovë, për shkak të bindjeve të tij politike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Bindjet politike

Fusha: Punësim